



Kreu i Organizatës Botërore të Turizmit, Taleb Rifai: Të dhënat e turizmit nga Shqipëria dëshmojnë për ndryshime të dukshme



Shqipëria është pjesë e një prej panairove më të rëndësishëm të turizmit në botë, atë të “World Tavel Market” në Londër. Përmes standës së saj, MZHETTS dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit prezantuan Shqipërinë Turistike përmes fotove dhe videove ku shfaqen bukuritë natyrore dhe tradita kulturore e historike. 15 tur operatorë nga Shqipëria morën pjesë në këtë panair. Tematika e këtij panairi, me pjesëmarrjen e 5000 egzibitorëve nga 182 shtete dhe mbi 50.000 vizitorë, është promovimi i turizmit dhe udhëtimet. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, e pranishme në këtë panair thotë se: “për Shqipërinë natyrisht që është një ngjarje e rëndësishme pjesëmarrja në panairin WTM Londër jo vetëm për turizmin, por edhe për sipërmarrjen turistike. Shqipëria promovohet në Europë nëpërmjet dy panairove të mëdha, ITB Berlinit dhe WTM Londër ku bëhet pjesëmarrëse. Në këto panairove sipërmarrja turistike shqiptare nuk kontakton vetëm tour operatorët për Europën, por dhe më gjerë, sepse është një panair mbarë botëror. Një operator turistik nga Shqipëria kontakton jo vetëm me operatorët nga Europa, por edhe nga operatorë që vijnë nga vende të largëta të Azisë dhe Amerikës. Ka shumë mundësi për ta prezantuar Shqipërinë turistike dhe ofertave që vijnë prej sipërmarrjes turistike shqiptare po te drejtohesh në standën e Shqipërisë”, - u shpreh ministria Ekonomi. Krahas këtij panairi të Londrës, ministria Ekonomi tha se “duhet të mendojmë që ka nevojë dhe për shtrirje të tjera gjeografike në pjesëmarrjet e panairove ku përveç Berlinit edhe Londrës, të mund të shikohet mundësia për panairove që ofrojnë turistin që vjen nga vendet e Lindjes, si për shembull Rusia, Ukraina, Japonia, Kina, apo dhe vende si Emiratet e Bashkuara Arabe, apo të tjera zona që kanë interes për kulturën shqiptare dhe për atë që Shqipëria shfaq si vend i panjohur deri më tani”. Ministria Ekonomi, gjatë qëndrimit në Londër, zhvilloi një takim dhe me Kreun e Organizatës Botërore të Turizmit, z. Taleb Rifai, të cilin e njohu me zhvillimet më të fundit dhe përpjekjet e qeverisë shqiptare për t'i dhënë këtij sektori mbështetje dhe vizionin e duhur. Z.Rifai u shpreh se “Të dhënat e turizmit nga Shqipëria dëshmojnë rritje dhe ndryshime të dukshme për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj tij”. Pas takimit me ministren Ekonomi, kreu i Organizatës Botërore të Turizmit dha këtë koment. “Në të shkuarën e kam vizituar Shqipërinë dy herë dhe do të zhvilloj një vizitë tjetër në 2017. Unë kam vënë re se ndryshimet në turizmin shqiptar janë qartësisht të dukshme.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/kreu-i-organizates-boterore-te-turizmit-taleb-rifai-te-dhenat-e-turizmit-nga-shqiperia-deshmojne-per-ndryshime-te-dukshme-ne-turizem&page=1>

Lordi Alan Watson, mbështetje dhe promovim turizmit shqiptar në Britani



Për herë të parë në Dhomën e Lordëve të Parlamentit Britanik u mbajt aktiviteti “Arritjet dhe e ardhmja e industrisë turizmit në Shqipëri”. Lord Alan Watson of Richmond, një mik i Shqipërisë dhe shqiptarëve, ofroi mbështetjen e tij personale për promovimin e mëtejshëm të turizmit në Britaninë e Madhe. Në këtë aktivitet, në tempullin e demokracisë botërore, organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri -Britani e Madhe në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Komisionin Parlamentar Britanik të miqësisë mes Shqipërisë e Mbretërisë së Bashkuar, Agjencinë Kombëtare të Turizmit, ambasadën e Shqipërisë në Londër, nën kujdesin direkt të Lord Alan Watson, ku mori pjesë edhe Milva Ekonomi, Ministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Zonja Madelein Moon, kryetare e grupit të miqësisë. Zonja Moon, e cila mori këtë detyrë pak kohë më parë, tregoi se vizitat e saj në Shqipëri nga viti 2006 kur ajo erdhi për herë të parë në Rubik e Krujë, dhe kur u kthye në 2016, ajo që vazhonte t’i bënte përshtypje ishte mikpritja e pandryshuar njerëzore e shqiptare. Ruaje këtë pasuri të çmuar të vendit. Është një nder dhe privilegj i veçantë për mua, tha ministrja Ekonomi, që nga Dhoma e Lordëve të flasim sëbashku për turizmin shqiptar dhe sfidat e përditshme, për ta kthyer turizmin në një kontribues akoma edhe më të rëndësishëm në ekonominë shqiptare. “Mikpritja shqiptare, të cilën e nënvizoi në fjalën e tij i nderuari Lord Alan Watson of Richmond dhe zonja Moon, është një aset me vlera për turizmin shqiptar. Por, Shqipëria me mikpritjen e saj mund të tregojë këndshëm historinë e saj, muzetë e rinovuar rishtazi apo edhe ato vende të cilat kanë marrë statusin e mbrojtjes nga UNESCO. Shqipëria është një vend i bukur dhe i sigurt. Është një vend që ofron mundësi të shijosh bregun, kodrën dhe malin, por edhe kuzhinën e shijshme të gatuar me produkte bio dhe lokale. Këto vite Shqipëria ka përmirësuar aq shumë shërbimet e saj HORECA, sa e bën të krahasueshme me shumë vende të tjera të Mesdheut dhe mbase edhe më mirë. Shqipëria është një vend i sigurt, ku toleranca fetare është një vlerë e shtuar në historinë dhe mikpritjen njerëzore.”- u shpreh ministrja Ekonomi. Ndihma dhe mbështetja e Dhomës së Lordëve, tha ministrja Ekonomi, në çdo lloj forme për promovimin e turizmit merr vlera të jashtëzakonshme për Shqipërinë. Duke i dhënë vëmendje turizmit, Shqipëria po lehtëson dhe po mbështet investimet strategjike në mbështetje të fuqizimit të këtij sektori. Ka shumë mundësi të investohet në strukturat akomaduese, infrastrukturë dhe në marina. “Faleminderit Lord Alan Watson of Richmond, Zonja Moon, Zoti Grogan dhe të gjithë miqve të Shqipërisë në Parlamentin Britanik për mbështetjen e vazhdueshme dhe promovimin e Shqipërisë Turistike”,- tha ministrja Ekonomi. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe investitorë britanikë, operatorë turistike nga Shqipëria dhe Britania e Madhe, biznesmenë shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Britani të Madhe.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/lordi-alan-watson-mbeshtetje-dhe-promovim-turizmit-shqiptare-ne-britani&page=1>

Londër/Ministrja Ekonomi në samitin e ministrave të turizmit



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Znj. Milva Ekonomi, mori pjesë në samitin e ministrave të turizmit organizuar në Londër. Ministrat e turizmit nga 100 vende të botës, drejtues të sektorit privat, kompani dhe shoqatat e turizmit u bënë bashkë në aktivitetin e organizuar nga World Tourism Organization (UNWTO) dhe World Travel Market në Londër. Fokusi i këtij samiti ishte siguria e turistëve në destinacionet që ata zgjedhin për të pushuar. Taleb Rifai kreu i UNWTO në fjalën përshëndetëse në ministerial tha se “ne duhet ta bëjmë turizmin të sigurtë dhe në të njëjtën kohë miqësor. Ky samit i drejtohet industrisë së turizmit dhe qeverive për të punuar bashkërisht në ndihmë të destinacioneve për tu përballur me kërcënimin e terrorizmit për të mundur këto forca të errëta”. Ai theksoi se “qetësia dhe siguria janë dy shtylla kryesore të zhvillimit dhe turizmit dhe ne duhet ti forcojmë ato më shumë duke ndërmarrë veprime të përbashkëta në pasjen e destinacioneve të sigurta. Ky ministerial shërben të ecim përpara për tu përballur me sfidat në fushën e sigurisë”. UNWTO vitin e ardhshëm do të nisë një program trajnimi në të gjithë botën me rreth 1 milion të punësuar në sektorin e turizmit dhe udhëtimeve për çështjet e sigurisë përfshi edhe rastet kur ka kriza dhe fatkeqësi natyrore.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/londer-ministrja-ekonomi-ne-samitin-e-ministrave-te-turizmit&page=1>

DPA firmos marrëveshjen ILAC – MRA në një ceremoni të organizuar në New Delhi, Indi



Nga data 26 Tetor – 4 Nëntor 2016, në New Delhi, Indi u zhvillua Asambleja e Përgjithshme e dy organizmave Ndërkombëtare të Akreditimit, IAF (Forumi Ndërkombëtar Akreditimit) dhe ILAC (Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Akreditimit të Laboratorëve). Si pjesë e aktiviteteve ishte dhe një ceremoni për vendet, të cilat kanë aplikuar dhe nënshkruar Marrëveshjen e Njohjes Reciproke shumëpalëshe me ILAC dhe IAF.

Z. Armond Halebi, Drejtor i Përgjithshëm i DPA dhe z. Peter Unger, kryetar i ILAC, nënshkruan Marrëveshjen e Njohjeve Reciproke në fushën e Testimit dhe pranimit të DPA anëtare me të drejta të plotë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje ka një impakt për laboratorët testues të akredituar nga DPA, certifikatat e të cilëve janë ekuivalente dhe të pranuar në nivel Ndërkombëtar. Por, gjithashtu ka impakt dhe tek komuniteti i Biznesit, pasi ndikon në reduktimin e barrierave teknike në tregti, duke lehtësuar dhe bërë më pak të kushtueshëm eksportin e produkteve, pasi nuk do të duhet ti nënshtrohen procesit të ri-testimit. DPA tashmë është anëtar me të drejta të plotë në dy organizmat Ndërkombëtare të Akreditimit ILAF – IAF, dhe në Organizmin Evropian të Akreditimit – EA. Gjithashtu, është firmosës i marrëveshjeve të Njohjes Reciproke në fushën e testimit dhe me Organizmin Evropian të Akreditimit. Organizma të tjera të cilët nënshkruan me Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Akreditimit të Laboratorëve – ILAC, marrëveshje në fushën e testimit, kalibrimit, inspektimit ishin Bullgaria, Kili, Mongolia, Nikaragua, Arabia Saudite, Sri Lanka. Në këtë mbledhje u vendos edhe pranimi dhe ndryshimi i statusit për disa organizma . Në këtë mbledhje u diskutua edhe për disa ndryshime dhe rishikime të standardeve dhe udhëzuesve të ndryshëm. U vendos që standardin ISO/IEC 17011:2004 “Vlerësimi i Konformitetit— kërkesa të përgjithshme për organizmat akreditues që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit , pas publikimit në gusht 2017, faza tranzitore të jetë 3 vjet.

Pronësia industriale dhe mbrojtja e shpikjeve me patentë, leksion i hapur nga DPPM



Në datë 08/11/2016, në ambientet e Universitetit Politeknik i Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave zhvilloi një Leksion të hapur me studentet e nivelit Master shkencor të degës inxhinieri ekonomike të këtij Universiteti. Ky aktivitet kishte për qëllim përcjelljen e njohurive mbi pronësinë intelektuale dhe në veçanti njohuri mbi patentimin e shpikjeve, kriteret që duhet të plotësojë shpikja për të qenë e patentueshme, të drejtat që fitohen nëpërmjet regjistrimit dhe funksioni administrativ i DPPM. Gjithashtu studenteve iu prezantua mundësia e aksesit falas në mjetin i kërkimit për patenta në ESPACENET, i cili tashmë është i aksesueshëm edhe në gjuhën shqipe si rezultat i bashkëpunimit të DPPM dhe Zyrës Evropiane të Patentave që nga muaji gusht i vitit 2016 konkretisht në linkun <https://al.espacenet.com/>. Lektore ishte znj. Rezarta Rajta e cila, së bashku me profesorin e këtij fakulteti, z. Ilo Bodi, drejtuan këtë leksion dhe orientuan studentët drejt mundësive të mbrojtjes të krijimtarisë të tyre dhe kërkimit shkencor. Studentët u informuan që në vendin tonë sistemi i pronësisë intelektuale siguron mbrojtjen e shpikësve dhe punës së tyre nëpërmjet regjistrimit në DPPM. Në prezantime u sollën shembuj të shfrytëzimit tregtar të patentave dhe raste të mos patentimit të shpikjeve kur ato bien ndesh me baza morali të parashikuara në ligjin për pronësinë industriale dhe literaturën mbi patentat. Gjithashtu u shpërndanë fletëpalosje dhe libra me informacion mbi mbrojtjen e një patente nëpërmjet konventës për patentat evropiane. Ky është një aktivitet i shtuar për promovimin e IP e kryer nga DPPM. Studentëve ju urojme suksese në vitin e ri shkollor.

AIDA takon përfaqësues të Dhomës së Tregtisë të qytetit të Bursës



Më datë 7 Nëntor 2016, në ambientet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, u zhvillua një takim mes përfaqësuesve të saj dhe një grupi sipërmarrësish turq, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë të qytetit të Bursës, shoqëruar nga kryetari i Këshillit të Biznesit Shqipëri-Turqi. Gjatë takimit u mbajt një prezantim mbi mundësitë për investim që ofron vendi ynë, klimën e biznesit, avantazhet e sektorëve prioritarë, si dhe treguesit kryesorë makroekonomikë. Gjithashtu, pjesëmarrësit u njohën me kuadrin ligjor për investimet e huaja, si dhe lehtësitë e parashikuara për projektet me potencial strategjik në zbatim të ligjit për investimet strategjike. Sipërmarrësit turq u njohën dhe me shërbimet që ofron Agjencia AIDA, duke filluar nga informacioni dhe asistenca në çdo hap deri në realizimin e projekteve të investimit. Në këtë takim u prezantua edhe vënia në dispozicion të investitorëve Zona e Lirë Teknologjike e Spitallës.

AIDA/ Trajnim për vizitat "aftercare" tek investitorët



Me asistencën e IFC/Bankës Botërore është zhvilluar workshopi me temë "Preparing for investors Aftercare visits", nën kujdesin e AIDA-s dhe mbështetjen e IFC/ Bankës Botërore. Programi ka vijuar me trajnimin e dy bashkive nismëtare Elbasan dhe Lezhë, ku fokusi është kujdesi për investitorët ekzistues nëpërmjet shërbimit "after care". AIDA beson në një bashkëpunim më të ngushtë me qeverisjen lokale, duke qenë në një sinergji të përbashkët kundrejt shërbimit të investitorëve të huaj të pranishëm dhe gjenerimin e investitorëve të rinj. IFC/Banka Botërore mbështet zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri, fokusuar kryesisht në fusha si shkëmbime tregtare, investime dhe konkurrueshmërinë e biznesit. Në këtë kuadër, IFC/ Banka Botërore po mbështet AIDA-n për të krijuar një mekanizëm në zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të investitorëve në Shqipëri, për të përmirësuar shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme të investitorëve dhe lehtësimin e ri-investimeve në vend.



Adresa: Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: zmp@ekonomia.gov.al

Web: www.ekonomia.gov.al

